



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Ndërhyrje emergjente dhe mbrojtjeje në infrastrukturen rrugore në Njësitë Administrative dhe Qytet.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi CPV:** 90640000-5 - Shërbime të pastrimit dhe zbrasjes së kanaleve, 90620000-9 - Shërbime të pastrimit të borës, 77314000-4 - Shërbime të mirëmbajtjes së tokës, 45243100-3 - Punime të mbrojtjes shkëmbore

**VLERA E FONDIT LIMIT: 33,332,808** (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e teteqind e tete) lekë pa TVSH ose 364,332 (treqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e treqind e tridhjetë e dy) euro.

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 21.09.2026 është 91.49 Lekë/Euro.**

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkise viti 2026 i miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor Afatmesëm perfundimtar 2026 - 2028 te Bashkise se Shkodres", i ndryshur.

Procedura e prokurimit do te jete e llojit **Marreveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj** mbeshtetur në nenin 52 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar dhe sipas nenin 60, pika 1/ç, nenit 62, neni 63, neni 64 pika 1/a , neni 65, neni 66 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Udhëzimit nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" e ndryshuar.

Arsyeja e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara justifikohet nga natyra e përsëritur e nevojave për mirëmbajtjen e rrugëve në zonat rurale dhe qytet, si dhe nga pamundësia për të përcaktuar me saktësi, që në momentin e zhvillimit të procedurës, segmentet konkrete, volumin dhe kohën e ndërhyrjeve që do të kërkohen gjatë periudhës së kontraktimit. Nevojat për ndërhyrje varen ndër të tjera nga kushtet atmosferike, dëmtimet e infrastrukturës rrugore, fenomenet natyrore dhe gjendja e rrjetit rrugor. Marrëveshja Kuadër krijon mundësinë që kushtet bazë të kontraktimit të përcaktohen paraprakisht, ndërsa realizimi konkret i punimeve të kryhet në funksion të nevojave reale që do të lindin gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për

të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së vlerës së përllogaritur të kontratës e konkretisht **13,333,123** (Trembedhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, si dhe bazuar në nenin **43, pika 2/4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

**2.2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë Administratës Tatimore dhe të konfirmuara prej saj, të shoqëruara me raportin e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, në rastet kur subjekti është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk evidentohet raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për (Sipas QKB) për vitin 2026 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.2.2, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njesuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 5/ c), nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **13,333,123 (Trembedhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”*ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata të zbatuara në të shkuarën*” dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Për kontrata të mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar*

*duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 20 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates”””.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **13,333,123 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë** përbën nivelin maksimal prej 40% të përvojes së mëparshme që lejon LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçensë profesionale lëshuar nga organet perkatese, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjelles gazsjelles ,vajsjellesa vepra kullimi dhe vaditje”

**Punime speciale ndërtimi:**

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime për prishjen e ndertimeve”

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jo ndricuese”

Kategoria NS-7 Niveli A “Barriera dhe mbrojtje rrugore”

Kategoria NS-8 Niveli A “Ndertime p/f me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”..

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e liçensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që*

*ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, 'Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi', i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa për disponimin e licencës profesionale të zbatimit, me kategoritë dhe nivelet e përcaktuara në pikën 2.3.2, është vendosur në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, dhe legjislacionin në fuqi për licencimin profesional të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ndërtimore.

Megjithëse objekti i prokurimit është një kontratë shërbimi për mirëmbajtjen vjetore të rrugëve, realizimi i saj përfshin ndërhyrje konkrete në infrastrukturën rrugore, të cilat, sipas natyrës së tyre, përfshijnë punime gërmimi, rrugore, kullimi, prishjeje, sinjalistike, barriera dhe mbrojtje rrugore, ndërhyrje në struktura, si dhe punime topogjeodezike. Për këtë arsye, disponimi i kategorive përkatëse të licencës profesionale është i nevojshëm për garantimin e aftësisë profesionale dhe ligjore të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimit.

Kategoritë e kërkuara **NP-1, NP-4, NP-7, NS-1, NS-6, NS-7, NS-8 dhe NS-18** janë përcaktuar në përputhje me zërat konkretë të preventivit dhe me natyrën e ndërhyrjeve që parashikohen të realizohen gjatë periudhës së mirëmbajtjes. Për secilën kategori është marrë në konsideratë edhe **vlera përkatëse e zërave të preventivit**, mbi bazën e së cilës është përcaktuar niveli i licencës së kërkuar.

Në këtë mënyrë, kërkesa për licencë profesionale është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me vëllimin e punimeve që do të realizohen, ndërsa përcaktimi i nivelit A është bërë në raport me vlerat dhe përmasat e ndërhyrjeve të parashikuara në preventiv. Kriteri nuk synon kufizimin e konkurrencës, por verifikimin paraprak të aftësisë profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në përputhje me kërkesat teknike dhe legjislacionin në fuqi.

Për rrjedhojë, kërkesa është **e përshtatshme, e nevojshme dhe proporcionale me objektin, natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës**, si dhe në përputhje me parimet e konkurrencës, transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

| <b>Kategoria e kërkuar</b> | <b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>         | <b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>                                                                          | <b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</b> | <b>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b> |
|----------------------------|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <u>Kategoria NP-1</u>      | Punime germimi                                                        | Zeri nr 1Kap 1,<br>zeri nr (2-9) kap2                                                                                                                                          | Niveli A                                                         | 2,554,440.60<br>leke pa tvsh                                                                          |
| <u>Kategoria NP-4</u>      | Rruge<br>,autostrada,mbikalime                                        | Zeri nr (11-19)Kap 3,<br>zeri nr (21-22)Kap 4,<br>zeri nr (23-24) Kap5,<br>zeri nr (25-28) Kap6,<br>zeri nr (32,34,38-39) Kap 8,<br>zeri nr 42Kap 9,<br>zeri nr (54-55) Kap 13 | Niveli A                                                         | 21,602,589.37<br>leke pa tvsh                                                                         |
| <u>Kategoria NP-7</u>      | Ujesjelles,gazsjelles,vepra<br>kullimi dhe vaditje                    | Zeri nr 29 Kap6,<br>zeri nr (35-37,40)Kap8                                                                                                                                     | Niveli A                                                         | 1,211,142.41<br>leke pa tvsh                                                                          |
| <u>Kategoria NS-1</u>      | Punime per prishjen e<br>ndertimeve                                   | Zeri nr 20 Kap 3,<br>zeri nr 56 Kap14,<br>zeri nr (58-59)Kap15,                                                                                                                | Niveli A                                                         | 651,063.27 leke<br>pa tvsh                                                                            |
| <u>Kategoria NS-6</u>      | Sinjalistike rrugore jo<br>ndriçuese                                  | Zeri nr (44,46) Kap10,<br>zeri nr (47-49)Kap11,<br>zeri nr(50-53) Kap12                                                                                                        | Niveli A                                                         | 1,126,236.37leke<br>pa tvsh                                                                           |
| <u>Kategoria NS-7</u>      | Barriera dhe mbrojtje<br>rrugore                                      | Zeri nr 33 Kap 8,<br>Zeri nr 45Kap10                                                                                                                                           | Niveli A                                                         | 827,869.41 leke<br>pa tvsh                                                                            |
| <u>Kategoria NS-8</u>      | Ndertime p/f prej betoni te<br>armuar,struktura metalike<br>dhe druri | Zeri nr(30-31) Kap7,<br>zeri nr 43 Kap9,<br>zeri nr(57,60) Kap 15                                                                                                              | Niveli A                                                         | 2,118,398.39<br>leke pa tvsh                                                                          |
| <u>Kategoria NS-18</u>     | Punime topogjeodezike                                                 | -                                                                                                                                                                              | Niveli A                                                         | -                                                                                                     |

### 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik të perfshire ne liçensen e shoqerise për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier topograf

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet te dorezoje prane AK ,dokumentat provuese per vetdeklarimet ne formularin permbledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.3.3, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve **të ndërtimit, topograf** është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.4** Vetdeklarimin nga **inxhinierët e mësipërm** se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin nr. 6732, datë 21.10.2020 ”Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të shërbimit të ndërhyrjeve dhe mirëmbajeve**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndërtimi dhe të deklarojë se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

*Në rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varësi të vlerës se preventivit të shërbimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit.*

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, duhet të dorezojë prane AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, siç kërkohej, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.*

**Argumentimi:** Së pari, kërkesa për përcaktimin e një **Drejtuesi Teknik të shërbimit të ndërhyrjeve dhe mirëmbajtjeve** është përcaktuar në funksion të objektit të kontratës dhe të nevojës për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Duke pasur parasysh natyrën e shërbimit, i cili përfshin ndërhyrje dhe mirëmbajtje me karakter teknik dhe ndërtimor, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një profesionist me formimin dhe kompetencat teknike përkatëse, konkretisht **inxhinier ndërtimi**, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin teknik të shërbimit gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për përcaktimin e këtij personi synon të sigurojë që shërbimet e ndërhyrjeve dhe mirëmbajtjes të realizohen në mënyrë profesionale, në përputhje me kërkesat teknike të kontratës, dokumentet teknike, standardet e zbatueshme dhe legjislacionin në fuqi.

**Së dyti**, kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë **i përfshirë në licencën e shoqërisë** lidhet me natyrën teknike të shërbimit dhe me kërkesat ligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që kryejnë ndërhyrje dhe mirëmbajtje me karakter ndërtimor.

Në këtë drejtim, VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “**Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi**”, përcakton rregullat lidhur me Drejtuesin Teknik dhe kushtet në të cilat subjektet e licencuara ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Kërkesa për përfshirjen e Drejtuesit Teknik në licencën e shoqërisë, për rrjedhojë, nuk përbën një kërkesë të shkëputur nga objekti i kontratës, por synon të garantojë që personi i deklaruar nga operatori ekonomik është pjesë e strukturës teknike mbi të cilën mbështetet ushtrimi i ligjshëm i veprimtarisë së subjektit.

**Së treti**, kërkesa që Drejtuesi Teknik të deklarojë se është **i disponueshëm për realizimin e kontratës** është vendosur me qëllim garantimin e disponueshmërisë reale të kapacitetit teknik të deklaruar nga operatori ekonomik gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Disponueshmëria e personit të propozuar është e nevojshme për të siguruar që operatori ekonomik nuk deklaron vetëm formalisht një kapacitet profesional, por disponon realisht burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e shërbimit sipas kërkesave të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e **kontratës së punës së vlefshme dhe diplomës** synon, përkatësisht, të verifikojë lidhjen profesionale të Drejtuesit Teknik me operatorin ekonomik dhe përmbushjen e kërkesës për formimin profesional të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

**Së katërti**, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili operator të përcaktojë Drejtuesin Teknik në varësi të pjesës së shërbimit që merr përsipër lidhet me nevojën për të

garantuar që **kapacitetet teknike dhe profesionale të disponuara nga secili anëtar i bashkimit janë në përpjesëtim me përgjegjësitë dhe angazhimin që ai merr përsipër në realizimin e kontratës.**

Në këtë mënyrë, kërkesa nuk synon vendosjen e një barre të panevojshme mbi operatorët ekonomikë, por garantimin e një lidhjeje të arsyeshme ndërmjet kapacitetit teknik të kërkuar dhe pjesës së shërbimit që do të realizohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për sa më sipër, kriteri për përcaktimin e Drejtuesit Teknik të shërbimit të ndërhyrjeve dhe mirëmbajtjeve është përcaktuar në funksion të **objektit, natyrës dhe kompleksitetit teknik të shërbimit**, me qëllim garantimin e kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik dhe të realizimit të kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe dispozitat ligjore në fuqi.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me plotësimin e formularit sipas **Shtojcës 10 të Dokumenteve të Tenderit**, ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **11 (njëmbëdhjetë) punonjës.**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat përkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ,duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,sic kërkohej në pikën 2.3.6,duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 39, pika 6, gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Afati 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Sasia e oreve të punës sipas manualit sipas zerave të punimeve është:  $12446 : 8 : 264 = 5.89$  punonjës.

Nevojitet

1-teknik ndertimi

2 -shofer

2-manovrator

Totali 11 (njëmbëdhjetë) punonjës

Punonjësit nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), diplomë lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/organe/institute te akredituar, ose te *kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera* per manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën:

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), diploma të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/organe/institute te akredituar, ose te *kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera* per manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën:

|                 |         |          |
|-----------------|---------|----------|
| - Manovrator    | 2 (dy)  | punonjës |
| - Shofer        | 2 (një) | punonjës |
| - Murator       | 1 (një) | punonjës |
| - Hekurkthyes   | 1 (një) | punonjës |
| - Asfaltoshtues | 1 (një) | punonjës |
| - Saldator      | 1 (një) | punonjës |
| -Marangoz       | 1 (një) | punonjës |
| -Barrieriste    | 1 (një) | punonjës |

Manovratorët duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndërtimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/dëshmi nga organe/institute te akredituar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK ,dokumentat provuese për vetdeklarimet në*

*formularin permblledhes te vetdeklarimit,sic kerkohet ne piken 2.2.8,duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- 1 (një) Teknik ndërtimi nevojitet për organizimin e punimeve ne kantier
- 1 (një) murator nevojiten per kryerjen e punimeve te ndertimit, sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $5830:8:264=2,76$  punonjes. (1specialist+1 ndihmes)
- 1(nje) asfaltoshtgues nevojitet per kryerjen e procesit te asfaltimit, sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $560:8:264=0.265$  puntore. (1 specialist)
- 1 (një) hekurkthyes nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $69:8:264=0.03$  puntore. (1 specialist)
- 1(nje) saldator nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Saldatori duhet te jete punonjes i certifikuar per saldime te materialeve speciale. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $471:8:264=0.22$  puntore (1specialist)
- 1(nje) marangoz nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $568:8:264=0.26$  punonjes (1 specialist)
- Manovrator 2(dy) punonjes nevojitet per drejtimin e makinerive qe do te perdoren ne object
- Shofer 2(dy) punonjes nevoitet per drejtimin e automjeteve qe do te perdoren ne object
- Barrieriste (montues te barrierave dhe rrjetave ) duhet te jene punetor te trajnuar per montimin e guardrails dhe ankorimin e rrjetave. Per kete duhet te jene te pajisur me certifikata te formimit profesional si “Montues i Barrierave Metalike dhe Sinjalistikes Rrugore”. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:  $1135:8:264=0.53$  punonjes (1 specialist)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projektin dhe preventivin, duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe afatin e zbatimit të tyre. Autoriteti Kontraktor duhet të ketë garancinë se punimet do të kryhen nga persona të kualifikuar, me eksperiencë të mjaftueshme profesionale, në mënyrë që zbatimi të bëhet në përputhje me standardet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Për këtë arsye, për vërtetimin e kualifikimit të stafit teknik është kërkuar që specialistët të jenë të pajisur me diploma/dëshmi përkatëse, të lëshuara nga institucione të akredituara nga autoritetet shtetërore përgjegjëse. Certifikimet dhe diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga

institucione të licencuara nga organet kompetente, në mbështetje të ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në zbatim të këtij legjislacioni, certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga ministria përgjegjëse, nëpërmjet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional (AKAFP). Certifikatat e specialistëve duhet të jenë të regjistruara në regjistrat profesionale të AKAFP-së, duke garantuar vlefshmërinë dhe njohjen zyrtare të tyre.

Gjithashtu, kërkesa për dëshmitë e manovratorëve mbështetet në Urdhri nr. 200/2019, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimin e përdorimit të makinerive të ndërtimit”, duke siguruar që operatorët e makinerive të rënda të jenë të trajnuar dhe të certifikuar sipas kërkesave ligjore në fuqi.

**2.3.8** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

| <b>Nr</b> | <b>Mjetet</b>                                             | <b>Sasia</b> |
|-----------|-----------------------------------------------------------|--------------|
| 1         | Mjet transporti veteshkarkues $\geq 7$ ton (kapac.mbjtës) | 2 copë       |
| 2         | Kamionçina (kap mbajtës) (3-5) ton                        | 1 copë       |
| 3         | Eskavator me goma                                         | 1 copë       |
| 4         | Betoniere                                                 | 1 copë       |
| 5         | Grejder                                                   | 1 copë       |
| 6         | Autobot uji                                               | 1 copë       |
| 7         | Rrul me vibrim per ngjeshje çakelli                       | 1 copë       |
| 8         | Rrul per ngjeshje asfalti kapaciteti mbi 8 ton            | 1 copë       |
| 9         | Autobitumatrice                                           | 1 copë       |
| 10        | Asfaltoshtruese                                           | 1 copë       |
| 11        | Autovinç                                                  | 1 copë       |
| 12        | Aparat gazogjeni                                          | 1 copë       |
| 13        | Minifadrome                                               | 1 copë       |
| 14        | Makineri per skarifikimin e shtreses se asfaltit          | 1 copë       |
| 15        | Sperkates boje per vizime ne rruge(makineri ose paisje)   | 1 copë       |
| 16        | Borëpastruese (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)           | 1 copë       |
| 17        | Rimorkiator (Trailer)                                     | 1 copë       |
| 18        | Vinç eskavator me zinxhirë                                | 1 copë       |
| 19        | Elektrosaldatriçe                                         | 1 copë       |
| 20        | Rrul thikë                                                | 1 copë       |
| 21        | Fadrom                                                    | 1 copë       |
| 22        | Vibrator thellësie                                        | 1 copë       |

|    |                                                                                                                             |        |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|
| 23 | Makineri për montim guard rail (Batipal)                                                                                    | 1 copë |
| 24 | Trapan elektrik                                                                                                             | 1 copë |
| 25 | Makineri për hedhje kripe                                                                                                   | 1 copë |
| 26 | FABRIKE ASFALTI (e pajisur me leje mjedisore III.1.B, kur është në pronësi) në pronësi ose me qera ose kontratë marrvëshje. | 1 copë |

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- iii. Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Për mjetet e marra me qera që shënohen në regjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Kurse për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 10 të DT.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sic kërkohej në pikën 2.3.8, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara përmes kontratës së shitjes apo të qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci A.K se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të afateve të parashikuara në Grafikon e punimeve.

### **1-Mjet transporti vetshkarkues 15 ton (ngarkesa)**

Transport dhera  $m^3$   $1503 \cdot 1.6 = 2405$  ton

Transport çakëll rere e zhavor stabilizant  $m^3$   $1646 \cdot 1.8 = 2963$  ton

Transport material të ndryshme -100ton

Transport A/B + binder T- 476 ton

Totali  $5944:264=22.5$  ton:7ton=3.2 rruge ne dite, mestarisht (3-4) rruge ne dite (2 mjete me nga 1-2 rruge ne dite)

2-Mjeti I transportit me kapacitet (3-5) ton nevojitet per transportin e materialeve te ndertimit si cimento tuba material, elektrike etj

3-Betoniere nevojitet për përgatitjen e llaçeve dhe betoneve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.25,26,27,28,29**

4-Eskavatori me goma nevojitet per germim dheu sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.3,4,5,6**

5-Grejderi nevojitet per nivelimin e shtresave te cakellit dhe stabilizantit, sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.11,12,13,14,15,16,17,18,19**

6-Autoboti I ujit nevojitet per lagien me uje para ngjeshjes te shtreses se cakellit dhe stabilizantit sipas zerave te preventivit **Zeri nr.12,13,14,15,16**

7-Rrul per ngjeshje cakelli nevojitet per ngjeshjen e shtreses se cakellit dhe stabilizantit sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.12,13,14,15,16,**

8-Rrul per ngjeshje binderi dhe asfalti, nevojitet per ngjeshjen e shtreses se binderit dhe A/B sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.21,22,23,24**

9-Autobitumatricja nevojitet per lagien me bitum te shtreses se stabilizantit dhe binderit sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.14,15,16,21,22**

10-Asfaltoshtruesja nevojitet per hapjen ne rruge te shtreses se binderit dhe A/B. sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.21,22,23,24**

11-Autovinci nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.29,30,31,35,36,37,43,54,57**

12-Aparat gazogjeni nevojitet per kryerjen e punimeve te prishjes sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.43,57,58,59**

13-Minifadroma nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit dhe sipas projektit pasi eshte e nevojshme ne ate zone ku gjeresia e rruges nuk lejon te punohet me eskavator. **Zeri nr.12,13,14,15,16**

14-Makineri per skarifikimin e shtreses se asfaltit nevojitet per skarifikimin e shtreses ekzistuese te asfaltit. **Zeri nr.20**

15-Sperkates boje per vizime ne rruge (makineri ose paisje) nevojitet per kryerjen e punimeve te vizimit te rrugeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.47,48,49,50**

16-Borepastruese nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.65**

17-Rimorkiator nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.63**

18-Vinc eskavator me zinxhire nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.7,8,9**

19-Elektrosalatrice nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.43,60**

20-Rrul thike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.20,56**

21-Fadrome nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.34,38**

22-Vibrator thellesie nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.25,26,27,28,29**

23-Makineri per montimin e Guard rail (Batipal) nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.45**

24-Trapano elektrike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.54,55**

25-Makineri per hedhje kripe nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. **Zeri nr.66**

26- Fabrike asfalti nevojitet për prodhimin e asfaltit. **Zeri nr.21,22,23,24**

26- Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, për periudhën e zbatimit të kontratës, kapacitet të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm për furnizimin me asfalt të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik mund të disponojë impiantin/fabrikën e asfaltit:

në pronësi, me qira ose nëpërmjet një kontrate/marrëveshjeje të vlefshme furnizimi apo bashkëpunimi me një subjekt tjetër që disponon impiant/fabrikë asfalti.

Në rastin e pronësisë ose qirasë, operatori ekonomik paraqet dokumentacionin që provon të drejtën e pronësisë ose të përdorimit të impiantit.

Në rastin e mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër, operatori ekonomik paraqet angazhimin me shkrim të subjektit që disponon impiantin, ku përcaktohet qartë vënia në dispozicion e kapacitetit të nevojshëm për furnizimin me asfalt për realizimin e kësaj kontrate, për periudhën përkatëse të zbatimit.

Dokumentacioni duhet të mundësojë identifikimin e impiantit/fabrikës, subjektit që e disponon atë, vendndodhjen e tij dhe kapacitetin e deklaruar të furnizimit, në masën e nevojshme për realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dokumentacionin e paraqitur dhe disponueshmërinë reale të kapacitetit të deklaruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë një bazë logjistike për parkimin, stacionimin dhe dislokimin e mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara për realizimin e shërbimit, e cila duhet të jetë e pozicionuar në një distancë jo më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të përcaktuar për ndërhyrje, sipas përcaktimit të dokumenteve të tenderit.

Disponueshmëria e bazës logjistike duhet të provohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- a) dokument që provon pronësinë mbi pasurinë/ambientin që do të përdoret si bazë logjistike;
- b) kontratë qiraje të vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës, e lidhur me pronarin/personin që ka të drejtë ligjore ta japë pasurinë me qira;
- c) marrëveshje tjetër juridikisht të vlefshme që i jep operatorit ekonomik të drejtën e përdorimit të objektit/territorit si bazë logjistike për gjithë periudhën e kërkuar të kontratës.

Në çdo rast, dokumentacioni duhet të identifikojë qartë adresën/vendndodhjen e bazës, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përmbushjen e kërkesës së distancës dhe disponueshmërinë e saj gjatë zbatimit të kontratës. Baza logjistike dhe burimet kryesore të nevojshme duhet të jenë të organizuara në mënyrë që të mundësojnë reagimin brenda afatit të përcaktuar, duke marrë në konsideratë edhe kufirin e përcaktuar prej **50 km distancë rrugore nga qendra qytetit**.

**Argumentimi:** Përcaktimi i pozicionimit të bazës logjistike është mbështetur në nevojat funksionale dhe operacionale të autoritetit kontraktor, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në veçanti, kërkesa për pozicionimin e bazës në një distancë rreth **50 km** nga qendra qytetit nuk konsiderohet si një kufizim i vendosur drejtpërdrejt nga ligji, por si një kriter teknik dhe operacional i përcaktuar mbi bazën e nevojave konkrete të shërbimit, duke marrë në konsideratë kohën e reagimit në raste emergjente, aksesin në rrjetin rrugor, mundësinë e dislokimit të shpejtë të mjeteve të rënda, kushtet topografike dhe klimatike, si dhe nevojën për të garantuar një kapacitet logjistik të pavarur nga zona urbane.

Ky përcaktim duhet të jetë i lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe qëllimin e kontratës dhe proporcional me nevojat e autoritetit kontraktor, në përputhje me kërkesat e nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 për specifikimet teknike. Gjithashtu, kriteri nuk duhet të krijojë pengesa të pajustificuara për konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, distanca rreth **50 km** duhet të konsiderohet si rezultat i një vlerësimi teknik, territorial dhe operacional të nevojave për reagim emergjent dhe jo si një kërkesë arbitrare apo kufizim i pajustificuar i pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standarteve:

- a) Certifikatë: **ISO 9001/2015** -Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatë: **ISO 14001:2015**–“Sistemet e menaxhimit të ambientit” e vlefshme, ose ekuivalente.
- c) Certifikatë: **ISO 45001 : 2018** - Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- d) Certifikatën **SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021**, e përditësuar , e vlefshme ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të cilësisë në saldim e vlefshme ose ekuivalent).Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë , çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në aktmarrëveshje.

Pranohet edhe paraqitja e standarteve shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.4.1 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**ISO 9001:2015** Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde e cilësi , e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

**ISO 14001:2015** është një standard ndërkombëtar që ka të bëjë me menaxhimin e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullatorë për mbrojtjen e mjedisit. Kjo certifikatë siguron që kompania ndërtuese ka implementuar praktika dhe sisteme për të menaxhuar ndikimet mjedisore të punimeve, si ndotja e ajrit, ujërave dhe menaxhimi i mbetjeve.

**ISO 45001-2018** Sistemi i manaxhimit te sigurisë dhe shëndetit ne vendet e punës mundëson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e

*punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

**SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021** Standardi SSH EN ISO 3834-2:2021 përcakton kërkesa gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, si në punishte ashtu edhe në vendet e instalimit në terren. Për këtë arsye, zbatimi i kërkesave të këtij standardi krijon një kuadër të kontrolluar për organizimin dhe monitorimin e proceseve të saldimit që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Relacioni teknik, Specifikimet teknike, Grafiku, preventivi me zerrat e punimeve janë hartuar nga komisioni i ngritur me urdher të titullarit dhe janë pjese e DST.**

**Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit, specifikimet teknike ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent**